

LIGJ
Nr.7618, datë 8.10.1992

PËR MIRATIMIN E MEDALJES "MARTIR I DEMOKRACISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimin e medaljes "Martir i demokracisë".

Neni 2

Medalja "Martir i demokracisë" u jepet shtetasve shqiptarë ose të huaj që u martirizuan për veprimtarinë e tyre të shquar për lirinë, demokracinë dhe përparimin shoqëror të Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.315, datë 9.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.